



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit
Državni Tužilac / State Prosecutor

STRATEGJIA E KRIMEVE TË LUFTËS



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit
Državni Tužilac / State Prosecutor

STRATEGJIA E KRIMEVE TË LUFTËS

Prishtinë, shkurt 2019

Përmbajtja:

1. Pasqyrë e gjendjes aktuale.....	7
1.1. Rezultatet e pritura.....	10
1.2. Vlerësimi i resurseve të domosdoshme.....	12
2. Caktimi i përparësisë së lëndëve dhe përzgjedhja e lëndëve në bazë të kriterëve të përcaktuara.....	14
3. Rritja e kapaciteteve të prokurorisë dhe policisë.....	17
3.1. Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes Penale.....	20
3.2. Krijimi i një bazë të dhënash për krime të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare në Kosovë; Përditësimi i regjistrit elektronik të PSRK-Së.....	22
3.3. Bashkëpunimi rajonal.....	25
3.4. Bashkëpunimi me MTPN-në.....	27
3.5. Bashkëpunimi me Interpolin dhe Europolin.....	29
3.6. Bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile ("OShC") dhe Organizatat Joqeveritare ("OJQ").....	30
3.7. Dosjet e personave të zhdukur.....	31
3.8. Mbrojtja e dëshmitarëve.....	32
3.9. Mbështetje për viktimat, dëshmitarët dhe palët e dëmtuara.....	32
3.10. Strategjia mediale.....	37
4. Menaxhimi i rrezikut.....	38
5. Monitorimi i strategjisë.....	40

I. HYRJE

1. Pasqyrë e gjendjes aktuale

Një numër i madh i krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare – në formë të vrasjes së civilëve, zhvendosjes së detyruar të popullatës civilë, burgosjes së paligjshme, torturës, dhunës seksuale, trajtimit çnjerëzor, grabitjes dhe shkatërrimit të pronës, të pasurive ekonomike, objekteve kulturore dhe religjioze dhe veprave penale të tjera të ngjashme janë kryer në territorin e Kosovës në shkallë të gjerë apo sistematike në kontekst dhe si rrjedhojë e zhvillimit të luftës (konfliktit), e cila ndodhi në periudhën në mes viteve 1998 dhe 1999.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, hetimi dhe ndjekja penale efikase dhe efektive e krimeve të rënda, përkitazi, parimet e transparencës, lirisë nga ndërhyrja politike, respektin për të drejtat e njeriut dhe përgjegjësitë individuale penale, janë mjete thelbësore për përcaktimin e përgjegjësisë së kryerësve, vendosjen e drejtësisë për viktimat dhe palët e dëmtuara, si dhe për forcimin e sundimit të ligjit.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (në vijim: PSRK), që nga qershori i vitit 2018 ka marrë kompetencat ekskluzive për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe të së drejtës penale.¹

Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës, konkretisht Sektori për Personat e Zhdukur në Policinë e Kosovës (në vijim: NHKL e PK-së) është pjesë e Drejtorisë për Krime të Rënda në Departamentin e Hetimeve të Policisë së Kosovës dhe është njësi policore e specializuar dhe e autorizuar për hetimin e këtyre veprave penale pas pranimit-dorëzimit nga EULEX-i.

¹ UNMIK-u dhe më vonë EULEX-i kanë pasur kompetenca për këto kategori të lëndëve prej përfundimit të konfliktit deri më 2016-2018. Këto institucione kanë pasur mandat që t'i kryejnë të gjitha funksionet gjyqësore, të cilat zakonisht kryhen nga organet vendore dhe në emër të organeve vendore. Kjo strategji PSRK dhe NHKL e PK-së e pason pranimit-dorëzimin nga EULEX-i të PSRK dhe NHKL e PK-së.

Misioni për Sundim të Ligjit në Kosovë (në vijim: EULEX) ka transferuar dhe është duke transferuar të PSRK-ja afro nëntëqind (900) lëndë të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare. Gjithashtu, afro dymijë (2000) lëndë për persona të zhdukur janë transferuar dhe janë në vijimësi të transferimit nga Njësia për Krime të Luftës e Policisë së EULEX-it të NHKL e PK-së.

Kundrejt sfondit të lartcekur, çështjet më kyçe janë si në vijim:

Spektori për Krime të Luftës i PSRK-së dhe NHKL e PK-së aktualisht nuk kanë kapacitete dhe burime të mjaftueshme për zhvillimin e hetimeve dhe ndjekjen penale të një numri aq të madh të lëndëve. Në periudhën që po vjen, numri ekzistues i të punësuarve duhet të përkohë me vëllimin e shtuar të punës që rrjedh nga transferimi i lëndëve nga EULEX-i.²

PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do të punojnë që t'i përcaktojnë prioritetet dhe kriteret për shqyrtimin e lëndëve të krimeve të luftës.

Periudha e gjatë kohore që ka kaluar që nga përfundimi i konfliktit në ish-Jugosllavi dhe, si rrjedhojë, mungesa e progresit në pjesën dërmuese të këtyre lëndëve gjatë mandateve të UNMIK-ut dhe EULEX-it, paraqet pengesa shtesë, të cilat PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do të punojnë për t'i tejkaluar.

Natyra unike e hetimit dhe ndjekjes penale të lëndëve të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit pas një periudhe të gjatë kohore, strategjitë për trajtimin e bregave të sigurisë të viktimave dhe dëshmitarëve dhe mekanizmat për ruajtjen dhe mbrojtjen e provave janë pjesë të detyrave, të cilat PSRK-ja dhe NHKL e PK-së janë duke i marrë tashmë përsipër si çështje të prioritetit më të lartë.³

² Kriteret e EULEX-it për caktimin e prioritetëve në hetime dhe aktakuza, që nga tetori 2018, nuk janë ndarë me PSRK-në dhe NHKL e PK-së; prandaj, PSRK dhe NHKL e PK-së nuk e kanë pasur mundësinë e analizimit të prioritetëve dhe kriterëve të EULEX-it për t'i caktuar prioritetet dhe kriteret e tyre duke u bazuar në këtë vlerësim.

³ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan nga EULEX-i, para largimit të tij, përmbledhje gojore dhe me shkrim për PSRK-në dhe NHKL e PK-së për të siguruar shkëmbim informatash dhe ndërtim kapacitetesh gjithëpërfshirëse, duke u bazuar në përvojën e tyre. Shpresohet që PSRK-ja dhe NHKL e PK-së pastaj do të ishin në gjendje t'i analizonin masat e vendosura nga EULEX-i dhe ta përdornin atë kornizë si bazë për përforcimin e strategjisë për procedura të standardizuara përkitazi me mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve. Fatkeqësisht, EULEX-i nuk ofroi përmbledhje gojore apo me shkrim. PSRK-ja do të marrë përsipër vendosjen e masave efektive, duke i konsultuar praktikant më të mira ndërkombëtare.

Një tipar i veçantë i lëndëve të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare në Kosovë është paqasshmëria e të dyshuarve (që shpesh ndodhen në Serbi apo në shtetet e tjera në territorin e ish-Jugosllavisë) dhe të materialit provues (që shpesh ndodhet në TNPJ dhe organizata të tjera ndërkombëtare). Më konkretisht, shkalla e bashkëpunimit me Republikën e Serbisë në hetimin e krimeve të luftës nuk është e kënaqshme.

Provat që EULEX-i ka arritur t'i sigurojë në mënyrë të pavarur përmes bashkëpunimit ndërkombëtar kanë qenë shpesh të pamjaftueshme për ta dëshmuar përgjegjësinë penale, e cila ka rezultuar në një numër të konsiderueshëm të kallëzimeve penale që janë hedhur poshtë, pushim të hetimeve dhe aktgjykimeve liruese. Prandaj, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar është kusht vendimtar për hetimin dhe ndjekjen penale të suksesshme të këtyre krimeve. PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do të vazhdojnë të punojnë drejt bashkëpunimit më efektiv rajonal dhe ndërkombëtar.⁴

Në bazë të çështjeve të lartcekura është e domosdoshme të aprovohet një Strategji për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda, të përcaktuara sipas të drejtës ndërkombëtare në nivel kombëtar.

Fushëveprimi i Strategjisë është vlerësimi i gjendjes së tashme (pikat fillestare), përcaktimi i synimeve (objektivave) dhe masave të domosdoshme (veprimet e nevojshme) për organet shtetërore të përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës humanitare ndërkombëtare për ta përmirësuar koherencën e afateve, efikasitetin dhe efektivitetin e procedurave penale, përkitazi me këto raste, si dhe trajtimin e drejtë të të akuzuarve dhe qasjen në drejtësi të dëshmitarëve, viktimave dhe palëve të dëmtuara.

⁴ EULEX-i ka zhvilluar një kornizë të fuqishme të bashkëpunimit ndër-rajonal dhe ndërkombëtar dhe para përfundimit të mandatit të tij është dashur ta lehtësonte integrimin PSRK-së dhe NHKL të PK-së në kornizat tashmë të ngritura të bashkëpunimit. PSRK-ja dhe NHKL e PK-së pastaj do të kishin ndërmarrë zhvillimin e mëtejshëm të këtyre kornizave të bashkëpunimit dhe do ta kishin forcuar bashkëpunimin e tyre rajonal dhe ndërkombëtar. Në vend të kësaj, PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kanë marrë përsipër zhvillimin e këtyre kornizave për bashkëpunim në mënyrë të pavarur dhe prej fillimit.

Kjo strategji bazohet në strategjitë e ngjashme që zbatohen në rajonin e Ballkanit, duke i theksuar dhe zhvilluar veprimet që janë përshtatur me karakteristikat dhe nevojat e sistemit juridik të Kosovës.⁵

Në këtë strategji nuk do të kuptohet apo interpretohet asgjë në atë mënyrë që do të ndërhynte me kompetencën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, siç është vendosur me Ligjin nr.05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

1.1. Rezultatet e pritura

Rezultatet e pritura përmes zbatimit të kësaj strategjie përfshijnë metodat, në mënyrë që:

- a) Të sigurohet hetimi dhe ndjekja penale e pretendimeve serioze për krime të luftës dhe krime të tjera, sipas të drejtës ndërkombëtare dhe në përputhje me standardet e të drejtës ndërkombëtare penale, duke përfshirë zhdukjen e detyruar dhe vrasjen e personave të zhdukur gjatë dhe pas luftës;⁶
- b) Të sigurohet që lëndët grumbullohen dhe caktohen prioritetet e tyre me përqendrim në përgjegjësinë komanduese dhe kontrolluese në vend të shenjestrimit vetëm të të dyshuarve të nivelit të ulët;⁷
- c) Të sigurohet konfidencialiteti i hetimeve dhe dëshmime; ⁸
- d) Të sigurohet siguria e dëshmitarëve dhe e informatorëve; ⁹

⁵ Strategjia ishte menduar fillimisht për të siguruar që puna që bëhej nga EULEX-i, duke vepruar në emër të sektorit të drejtësisë në Kosovë, do t'i afrohej në mënyrë gjithëpërfshirëse PSRK-së dhe NHKL të PK-së. Po të ishte bërë kjo, PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do të kishin qenë në gjendje të merrnin si bazë punën e EULEX-it, duke i shfrytëzuar politikat, strategjitë, ekspertizën dhe bazat e të dhënave për lëndët, analizën dhe organizimin e provave, vendosjen e prioritetëve dhe të gjitha aspektet e tjera të zbatimit efektiv të sundimit të ligjit në Kosovë, të kryer nga EULEX-it në punën e vet në vazhdim pas pranimit-dorëzimit. Për fat të keq, nuk janë dorëzuar asnjëra prej këtyre politikave, strategjive, analizës dhe organizimit të provave, vendosja e prioritetëve, apo procedurave tjera operuese. Në vend të kësaj, PSRK dhe NHKL e PK-së kanë marrë përsipër zhvillimin e këtyre politikave dhe strategjive në mënyrë të pavarur dhe prej fillimit.

⁶ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kanë punuar për të siguruar pranimit-dorëzimin gjithëpërfshirës dhe transparent nga EULEX-i të PSRK-ja dhe NHKL e PK-së të të gjitha materialeve, analizës, procedurave, kornizave, provave, materialeve, pajisjeve, resurseve, njohurisë dhe sistemeve për të siguruar që puna e mirë e bërë nga EULEX-i në drejtimin e sistemit të drejtësisë së Kosovës të formojë bazën e marrjes përsipër efektive nga organet vendore.

⁷ Që nga tetori i vitit 2018, shumë dosje nuk janë dorëzuar, të tjerat janë dorëzuar të pakompletuara, me ç'rast janë hequr dokumente ose përmbajnë fotokopje, mbledhja e plotë e provave që ndodhen në databazën "Zylaf", e raportuar me 4.5 milionë hyrje nuk është dorëzuar ende dhe nuk janë dhënë asnjëra nga procedurat, kornizat apo sistemet. Në vend të kësaj, PSRK-ja dhe NHKL e PK-së tani vetë kanë ndërmarrë krijimin e procedurave të tilla që të përipiqen t'i përpunojnë dosjet pavarësisht se shumë prej tyre janë të pakompletuara.

⁸ Po të ishte ofruar në pranimit-dorëzim, prioritetizimi i EULEX-it për përgjegjësinë komanduese dhe kontrolluese do të kishte ofruar një themel dhe model për PSRK-në dhe NHKL të PK-së, ku do të kishin vazhduar punën. Nuk është e qartë nëse EULEX-i kishte zhvilluar ndonjë prioritetizim të tillë.

⁹ Po të ishin ofruar në pranimit-dorëzim, kriteret e qarta të EULEX-it dhe qartësia rreth konfidencialitetit të hetimeve dhe dëshmimeve do t'i kishin mundësuar PSRK-së dhe NHKL të PK-së ta vazhdojnë punën që është bërë deri më tash. Nuk është e qartë nëse EULEX-i kishte zhvilluar kriteret e tilla.

- e) Të sigurohet nivel i shtuar i ruajtjes së provave në rastet ku ka rrezik të konsiderueshëm që provat e tilla mund të mos jenë në dispozicion më pas në shqyrtim gjyqësor, duke pasur parasysh kohën e gjatë që ka kaluar që nga kryerja e pretenduar e krimeve;¹⁰
- f) Rritja e bashkëpunimit të organeve hetuese me Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave;¹¹
- g) Të sigurohet trajtim i barabartë i të dyshuarve dhe të pandehurve, pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare, etike dhe religjioze;¹²
- h) Rritet bashkëpunimi dhe bashkërendimi me të gjitha agjencitë kombëtare të angazhuara në hulumtimin dhe hetimin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare;¹³
- l) Rritet promovimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare;
- j) Rritet bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe shoqatat e familjeve të viktimave;¹⁴
- k) Rritet shkallës e vetëdijesimit publik për nevojën e hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare;¹⁵
- l) Të gjenden mënyra për t'i kapërcyer pengesat juridike, politike dhe të sigurisë gjatë përpjekjeve për të marrë informata të MTPN-së/TNPJ-së, përkritazi, me lëndët për Republikën e Kosovës dhe¹⁶
- m) Të sigurohet një përqendrim i veçantë në lëndët që përfshijnë krime të dhunës seksuale, por edhe të zhvillohen dhe zbatohen strategji për fuqizimin e të mbijetuarve përmes procesit të drejtësisë.¹⁷

¹⁰Po të ishte ofruar në pranim-dorëzim, ekspertiza e EULEX-it në këtë do t'u kishte mundësuar PSRK-së dhe NHKL të PK-së integrimin e strategjive të përfuqiuara të EULEX-it për ruajtjen e provave. Nuk është e qartë nëse EULEX-i kishte zhvilluar ndonjë strategji të tillë.

¹¹Po të ishte ofruar në pranim-dorëzim, përvoja e EULEX-it në këtë fushë mund t'i kishte hapur rrugë bashkëpunimit të PSRK-së dhe NHKL të PK-së me këtë agjenci.

¹²Po të ishin ofruar në pranim-dorëzim, do të kishte qenë e mundur që strategjitë apo politikat e EULEX-it të shfrytëzohen nga PSRK-ja dhe NHKL e PK-së. Nuk është e qartë nëse EULEX-i kishte zhvilluar strategji apo politika të tilla.

¹³Po të ishin ofruar në pranim-dorëzim, strategjitë apo politikat e EULEX-it për këtë çështje mund t'u kishin ndihmuar PSRK-së dhe NHKL të PK-së për shqyrtimin e këtyre strategjive dhe politikave, duke i përdorur si bazë për punën e tyre. Nuk është e qartë nëse EULEX-i kishte zhvilluar strategji apo politika të tilla.

¹⁴Po të ishte ofruar si pjesë e pranim-dorëzimit, EULEX-i do të kishte mundur të lehtësonte forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, në mënyrë që marrëdhëniet e ndërhuara përgjatë mandatit të tyre do të ishin trashëguar dhe vazhduar lehtësisht nga PSRK-ja dhe NHKL të PK-së. Nuk është ndërmarrë ndonjë veprim i tillë.

¹⁵Si pjesë e pranim-dorëzimit, EULEX-i ka mundur t'i ofronte materialet që ata i kanë përdorur për ngritjen e vetëdijesimit publik, në mënyrë që PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do të kishin mundur ta shtojnë dhe vazhdojnë punën tutje. Nuk janë ofruar materiale të tilla. Nuk është e qartë nëse ka pasur materiale të tilla të përgatitura nga EULEX-i.

¹⁶Si pjesë e pranim-dorëzimit, EULEX-i ka mundur të ofronte udhëzime për këto pengesa për t'i mundësuar PSRK-së dhe NHKL të PK-së t'i vazhdojnë proceset tashmë të zhvilluara. Nuk janë ofruar udhëzime të tilla.

¹⁷EULEX- ka mundur të ofronte çfarëdolloj strategji që ata kanë zhvilluar gjatë mandatit të tyre. Nuk është e qartë nëse EULEX-i ka pasur ndonjë strategji apo politikë përkritazi me rastet që përfshijnë krimet e dhunës seksuale.

1.2. Vlerësimi i resurseve të domosdoshme

Këshilli Prokuritorial i Kosovës (në vijim: KPK) do ta themelojë një Task Forcë të përbërë nga përfaqësuesit e KPK-së, Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe NHKL e PK-së për të bërë përpunimin e një analize të resurseve që nevojiten për zbatimin e kësaj strategjie, me vëmendje të veçantë për numrin e prokurorëve, hetuesve, analistëve, zyrtarëve ligjorë, interpretëve, përkthyesve, personelit administrativ, resurseve financiare dhe pajisjeve teknike.¹⁸

1.3. Përkufizimi i krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare

Termi “Krimet e luftës dhe krimet e tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare” në këtë dokument do të kuptohet si të gjitha krimet e përcaktuara me nenet 2-5 të Statutit të Tribunalit Ndërkombëtar për ndjekjen penale të personave përgjegjës për shkeljet e rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të kryera në territorin e ish-Jugosllavisë që nga vitit 1991 (shkelje të rënda të konventave të Gjenevës të vitit 1949, shkeljet e ligjeve apo zakoneve të luftës, gjenocid dhe krime kundër njerëzimit), të gjitha krimet e përcaktuara në Kapitullin 16 të Kodit Penal të ish-Republikës Federale të Jugosllavisë, si dhe të gjitha krimet e përcaktuara me nenet 148 -163 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Përkufizimi i dhënë më lart përfshin aktet kriminale kundër pasurisë kulturore, zhdukjen e detyruar, zhdukjen, rrëmbimet dhe vrasjen e personave të zhdukur gjatë periudhës kohore që përfshihet nga kjo strategji deri në masën që këto ngjarje përbëjnë krime lufte apo shkelje të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare.

1.4. Korniza relevante normative e Kosovës

Korniza e tashme normative për hetimin dhe ndjekjen e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare përbëhet nga këto akte normative:

- a) Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- b) Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 (neni I) për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 për ligjin në fuqi në Kosovë;

¹⁸ Si pjesë e pranim-dorëzimit, EULEX-i ka mundur të ofronte një listë gjithëpërfshirëse të resurseve dhe materialeve dhe pajisjeve teknike që do të ofroheshin nga EULEX-i për PSRK-në dhe NHKL të PK-së, në mënyrë që KPK-ja të mund të mbështetej në ato materiale dhe resurse për ta krijuar analizën e saj rreth resurseve që nevojiten. Nuk është ofruar një listë e tillë e resurseve.

- c) Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.27/08), i ndryshuar;
- d) Ligji nr.03/L –225, për Prokurorin e Shtetit (Gazeta Zyrtare nr. 89/10), i ndryshuar;
- e) Ligji nr. 04/l-015, për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (Gazeta Zyrtare nr. 13/11), i ndryshuar;
- f) Ligji nr.04/L –023, për Personat e Zhdukur (Gazeta Zyrtare nr. 16/11);
- g) Ligji nr. 04/L-082, Kodi Penal i Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06/L -074), i ndryshuar;
- h) Ligji nr. 04/L-123, Kodi i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare nr. 37/12), i ndryshuar;
- i) Ligji nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar për Çështje Penale (Gazeta Zyrtare nr. 33/13);
- j) Ligji për Gjykata, Ligji nr. 06/L-054;
- k) Ligji nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore (Gazeta Zyrtare nr. 11/16);
- l) Ligji nr. 05/l-053, për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (Gazeta Zyrtare nr. 27/15);
- m) Memorandumet e bashkëpunimit;
- n) Rregullorja e Këshillit Prokurorial të Kosovës nr. 213/13, e datës 18 tetor 2013, për mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave;
- o) Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit nr. 181/2013, i datës 18 tetor 2013, për procedurat standarde të veprimit për Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave dhe
- p) Strategjia për Komunikim Publik e Sistemit Prokurorial 2018-2020.

1.5. Korniza relevante institucionale e Kosovës

Korniza e tashme institucionale për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare përfshin:

- a) Policinë e Kosovës, Njësinë për Hetimin e Krimeve të Luftës dhe Sektorin për Personat e Zhdukur (NHKL e PK-së);
- b) Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML);
- c) Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK);
- d) Prokurorinë e Apelit;
- e) Kryeprokurorin e Shtetit;
- f) Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave të Kryeprokurorit të Shtetit;

- g) Departamentin special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës brenda Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit të Kosovës;
- h) Gjykatën Supreme të Kosovës;
- i) Prokurorinë e Specializuar dhe
- j) Dhomat e Specializuara.

Pjesëmarrësit e tjerë institucionalë përfshijnë:

- K) Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK);
- l) Ministrinë e Drejtësisë dhe
- m) Ministrinë e Punëve të Brendshme.

II. STRATEGJIA

1. Caktimi i përparësisë së lëndëve dhe përzgjedhja e lëndëve në bazë të kriterëve të përcaktuar

a) Pikat fillestare

Afro nëntëqind (900) lëndë të natyrës së njëjtë tashmë janë të regjistruara në PSRK dhe janë dorëzuar nga prokurorët e EULEX-it. Përveç lëndëve, në të cilat janë lëshuar aktvendime për fillimin e hetimeve dhe vendimeve për fillimin e hetimeve, numri i përmendur përfshin lëndë nën hetime paraprake dhe lëndë të hedhura poshtë, të cilat mund të riaktivizohen nëse bëhen të disponueshme dëshmi të reja apo që mund të grumbullohen mes vete ose me lëndët aktive.

Gjithashtu, afro dymijë (2000) lëndë të personave të zhdukur duhet të vlerësohen.¹⁹ Nëse disa prej zhdukjeve apo rrëmbimeve përbëjnë shkelje të së drejtës ndërkombëtare humanitare, vëllimi i punës së PSRK-së dhe NHKL e PK-së do të rritet proporcionalisht.²⁰

¹⁹ Nga pranim-dorëzimi i EULEX-it është e qartë se këto lëndë për personat e zhdukur nuk janë përpunuar dhe nuk iu ka caktuar përparësia nga ana e EULEX-it gjatë tërë mandatit të tij. Nuk është ofruar ndonjë shpjegim për këtë.

²⁰ Këto është dashur të identifikohen nga ana e EULEX-it në vend se të lihen anash për dorëzim te PSRK-JA DHE NHKL e PK-së. PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do të bëjnë aktivizimin e këtyre lëndëve sa më parë që është e mundshme.

Nuk është reale të besohet apo pritët që të gjitha ato shkelje të pretenduara të së drejtës ndërkombëtare humanitare, të cilat janë kryer gjatë apo pas konfliktit, do të hetohen apo ndiqen penalisht në të njëjtën mënyrë dhe me të njëjtin përkushtim, posaçërisht, duke pasur parasysh resurset e kufizuara që janë ndarë për PSRK-në dhe NHKL të PK-së.

Për më tepër, në këtë kontekst, duhet të merret parasysh se pjesa dërrmuese e lëndëve të regjistruara të krimeve të luftës janë tejet të ndërlydhura, ngaqë burojnë nga raporte të ndryshme të viktimeve të veprimeve të njëjta të armatosura. Si të tilla, lëndët mund të rigrupohen në bazë të afërsisë gjeografike dhe kohore dhe të hetohen bashkërisht (“Grumbullimi”).

Për këtë arsye është thelbësore që hetimi dhe ndjekja penale e lëndëve të shkeljes të së drejtës humanitare ndërkombëtare t'i nënshtrohen një strategjie të caktimit të përparësisë, duke u bazuar në kriteret e përcaktuara.²¹

Kjo gjë do t'u ndihmojë prokurorëve dhe hetuesve me resurse dhe kohë jashtëzakonisht të kufizuar për kategorizimin dhe klasifikimin e lëndëve, me qëllim të gjetjes së lëndëve më të përshtatshme, në mënyrë që të parat të hetohen dhe ndiqen penalisht.

b) Synimet

PSRK në konsultim me NHKL të PK-së do t'i përcaktojnë kriteret për përzgjedhjen e lëndëve të krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe do ta hartojnë një listë të përparësisë dhe lëndëve madhore për ta përmbushur obligimin që të gjitha lëndët me përparësi dhe të rëndësishme të hetohen dhe të ndiqen penalisht.²²

²¹ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuar nga EULEX-i që t'ua ofrojnë PSRK-së strategjinë e tyre për caktimin e përparësisë, për të cilën PSRK-ja mund zhvillojë strategjinë e vet përderisa i trashëgon lëndët nga EULEX-i. Nuk është ofruar një strategji e tillë.

²² PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuar nga EULEX-i që nëntëqind (900) lëndët e dorëzuara të organizohen dhe grumbullohen sipas kriterëve për përzgjedhje dhe caktim të prioritetëve të kryer nga EULEX-i. Po të ishte ofruar kjo, PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do ta kishin marrë prioritetimin e ofruar nga EULEX-i dhe do ta zhvillonin mbi të strategjinë e tyre në momentin kur i trashëgojnë lëndët nga EULEX-i. EULEX-i nuk ofroi ndonjë grumbullim apo prioritetim të tillë. PSRK-ja dhe NHKL e PK-së do ta marrin përsipër zhvillimin e tyre.

c) Veprimet e nevojshme

Kryeprokurori i PSRK-së duhet të lëshojë një urdhëresë për caktimin e prioriteteve të lëndëve, në të cilën radhiten kriteret e përshtatshme, me qëllim të përcaktimit të lëndëve me përparësi, duke u bazuar në listat e ngjashme të hartuara nga organet ndërkombëtare të ndjekjes penale dhe duke i përfshirë së paku edhe: ²³

- a) Pozitat në hierarki nën hetim;
- b) Pozitat e udhëheqësve politikë, ushtarakë, paraushtarakë dhe udhëheqësit civilë;
- c) Rolin dhe pjesëmarrjen në çështjet e politikave dhe strategjive;
- d) Fajësinë personale për krimet specifike;
- e) Shkallën e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në ngjarjet e pretenduara;
- f) Autoritetin dhe kontrollin e ushtruar nga i dyshuari;
- g) Mënyrën e krimit, duke pasur parasysh në veçanti faktorët rëndues, siç janë: mizori e veçantë, shënjestrim posaçërisht i viktimave të pambrojtura, keqpërdorimi i autoritetit;
- h) Disponueshmërinë e provave dhe dëshmitarëve;
- i) Numrin e viktimave;
- j) Llojin e aktive (sikurse dhuna seksuale);
- k) Kohëzgjatjen dhe përsëritjen e veprës penale;
- l) Krimet mostër dhe lëndët emblematike;
- m) Resurset hetimore në dispozicion, fazën procedurale e lëndës, kufizimet kohore, urgjencën në kuptim të afateve kohore, përfshirë kohën prej kallëzimit të parë nga ana e viktimës; ²⁴
- n) Çfarë punësh përgatitore ka bërë EULEX-i dhe
- o) Qasjen në informata dhe prova përkitazi me lëndën në materialet e ofruara nga EULEX-i.

²³ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan nga EULEX-i Urdhëresën e tyre për caktimin e përparësisë së lëndëve të zhvilluar nga EULEX-i gjersa kishin juridiksion mbi këto lëndë. As kjo urdhëresë nuk është ofruar.

²⁴ Dihet mirë se viktima të shumta bënë kallëzime te UNMIK-u dhe më vonë përsëri te EULEX-i dhe kurrë nuk morën ndonjë vendosje për rastet e tyre. Rastet e tilla të raportuara para një kohe të gjatë duhet të merren parasysh për priorizim së bashku me kriteret e tjera të paraqitura këtu.

3. Rritja e kapaciteteve të prokurorisë dhe policisë

a) Pikat fillestare

Në PSRK janë aktualisht në punë afro nëntëqind (900) lëndë të krimeve të luftës dhe lëndë që përfaqësojnë shkelje të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

Për të qenë në gjendje për ta përballuar mbingarkesën e dosjeve që po dorëzohen nga EULEX-i te NHKL e PK-së, si dhe vëllimin aktual të lëndëve që ndërlidhen me krime të luftës, Kryeprokurori i Shtetit do t'i emërojë pesë (5) prokurorë, të cilët do të merren ekskluzivisht me lëndët e krimeve të luftës. Ata do të mbështeten nga gjashtë (6) zyrtarë ligjorë.

Kapaciteti i tashëm i NHKL të PK-së përbëhet nga 18 hetues. Policia e Kosovës do të punojë në drejtim të vazhdimit të përforcimit të njësisë, konkretisht, duke i përfshirë ata që mund të veprojnë si analist, interpretë, përkthyes dhe hetues të etnisë serbe.

Personeli i lartcekur do të përforcohet me mbështetjen e Kryeprokurorit të Shtetit për të siguruar që ata kanë resurse të mjaftueshme ta përballojnë ngarkesën e punës së PSRK-së dhe NHKL të PK-së.

b) Synimet

Të shfrytëzohen sa më mirë burimet njerëzore dhe të rriten maksimalisht gjasat e zbatimit të suksesshëm të kësaj strategjie gjersa numri i prokurorëve, hetuesve dhe i personelit mbështetës në Sektorin për Krime të Luftës të PSRK-së dhe të NHKL-së të PK-së të rritet proporcionalisht me numrin e lëndëve të regjistruara.

Të shtohet numri i prokurorëve, zyrtarëve ligjorë, asistentëve administrativë, hetuesve dhe asistentëve gjuhësorë, të caktuar në PSRK dhe NHKL të PK-së.

c) Veprimet e nevojshme

Kryeprokurori i PSRK-së duhet:

- i) Të nxjerrë një udhëzim të brendshëm që pesë (5) prokurorët e PSRK-së, të cilët së shpejti do të emërohen në Sektorin e Krimeve të Luftës të PSRK-së do të veprojnë si pika kontakti dhe bashkërendues për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, për shqyrtimin e lëndëve të transferuara nga EULEX-i dhe për grumbullimin e lëndëve të regjistruara. Atyre do t'u caktohen vetëm lëndët e shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe penale, që përfshijnë lëndët e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit;
- ii) T'u ricaktojë prokurorëve të caktuar në Sektorin për Krime të Luftës të gjitha lëndët për krime të luftës;
- iii) Të inkurajojë qarkullimin e informatave përbrenda Sektorit për Krime të Luftës me qëllim të hetimeve më efikase, duke iu lejuar të gjithë prokurorëve të caktuar në këtë sektor që të kenë qasje në të gjitha dosjet e krimeve të luftës, si dhe në të gjitha materialet dhe arkivat e informatat, që mbahen nga EULEX-i deri në fund të mandatit të tyre dhe që pastaj do të mbahen nga PSRK dhe NHKL e PK-së;
- iv) T'u caktojë lëndët e shkeljeve të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe penale të gjithë prokurorëve të caktuar në PSRK në bazë të kritereve të drejta dhe objektive që e marrin parasysh vëllimin e punës të secilit prokuror;
- v) T'u delegojë lëndët më pak të ndërlikuara (ato që nuk kanë të bëjnë me krime ndërkombëtare) prokurorëve të caktuar në prokuroritë themelore të Kosovës në përputhje me nenin 3, paragrafët 8, 9, 10 dhe 11 të Ligjit për PSRK-në dhe
- vi) Të ndajë resurse shtesë për rishikimin fillestar të lëndëve të dorëzuara.

Në pajtim me Kryeprokurorin e Shtetit, duke u bazuar në vlerësimin e vëllimit të punës nga Kryeprokurori i PSRK-së, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës të caktojë, në mënyrë të përkohshme apo të përhershme, zyrtarë policorë të NHKL e PK-së për rishikim fillestar të lëndëve të transferuara nga EULEX-i dhe për grumbullimin e lëndëve të regjistruara dhe për zhvillim të hetimeve. Ky rishikim do të përfshijë rishqyrtimin e materialeve që do të dorëzohen në bazën e të dhënave "Zylab", që thuhet se përmban afro 4.5 milionë hyrje, por që nga tetori 2018 ende nuk është në posedimin e NHKL të PK-së.²⁵

²⁵Që nga tetori 2018, EULEX-i kishte pohuar se baza e të dhënave "Zylab" me 4.5 milionë hyrjet e përlogaritura do t'i dorëzohet NHKL të PK-së posa të jenë në posedim të programit kompjuterik dhe licencës për "Zylab". NHKL e PK-së është e përkushtuar që të sigurojë se ka programin kompjuterik dhe mund ta marrë bazën e të dhënave.

Kryeprokurori i PSRK-së dhe Drejtori i NHKL të PK-së të krijojnë dhe zhvillojnë procedura të punës dhe udhëzime për çështjet e interesit të përbashkët.²⁶

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në bashkëpunim me KPK-së duhet të zhvillojnë dhe organizojnë trajnime të vazhdueshme për personelin e tashëm mbështetës dhe atë të punësuar apo caktuar rishtazi, për hetuesit dhe prokurorët e caktuar në NHKL të PK-së dhe PSRK-së, përkatësisht,²⁷ duke përfshirë trajnimet për:

- i) Të drejtën ndërkombëtare humanitare, të drejtën ndërkombëtare penale, praktikën gjyqësore të TNPJ-së,²⁸ databazën publike të TNPJ-së dhe teknikat hetimore;
- ii) Qasjen ndaj viktimave dhe dëshmitarëve në lëndët e shkeljes së të drejtës ndërkombëtare humanitare dhe dhunës seksuale në kohë të luftës, duke përfshirë viktimat si "palë të dëmtuara";
- iii) Zhvillimin e shkathtësive të specializuara intervistuese në rastet e dhunës seksuale dhe të bazuara në gjini gjatë kohës së luftës dhe në të kuptuarit e pasojave kulturore të dhunës seksuale në shoqërinë e Kosovës;
- iv) Zhvillimin e shkathtësive të specializuara hetimore për veprat penale kundër pasurisë kulturore dhe
- v) Zotërimin e gjuhëve të huaja dhe të teknologjisë informative.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të promovojë pjesëmarrjen e prokurorëve të PSRK-së në konferenca dhe projekte tematike rajonale dhe ndërkombëtare me qëllim të rritjes së përfshirjes dhe ekspertizës së prokurorëve të PSRK-së në fushën e krimeve të luftës dhe krimeve tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare dhe për rastet e personave të zhdukur.

Kryeprokurori i Shtetit dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës të angazhohen me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe KPK-në për t'i ngritur burimet njerëzore të PSRK-së (numër i shtuar i prokurorëve që do të caktohen në Sektorin për Krime Luftë, numër i shtuar i

²⁶ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i t'i dorëzojë procedurat dhe udhëzimet që të shërbejnë si udhëzues në kalimin dhe zhvillimin e procedurave dhe udhëzimeve. Asnjëra nuk u ofrua.

²⁷ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i t'i ofrojë Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së të gjitha modulet e trajnimeve që janë zhvilluar dhe zbatuar nga EULEX-i, përgjatë viteve të mandatit të tij. Nuk është ofruar asnjë modul.

²⁸ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i të ofrojë një përmbledhje të plotë dhe analizë të jurisprudencës së EULEX-it dhe UNMIK-ut. Nuk është ofruar asgjë.

zyrtarëve ligjor dhe asistentëve administrativ) dhe të NHKL-së të PK-së (numër i shtuar i zyrtarëve policor, krijimi i pozitave të analistëve, punësimi/ri-caktimi i zyrtarëve policor të etnisë serbe) për t'i bërë ato në përputhje me vëllimin e punës së zyrave dhe për të siguruar hetim dhe ndjekje penale efektive dhe efektive.

3.1. Ngritja e efikasitetit dhe efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale

a) Pikat fillestare

Duke pasur parasysh se ka kaluar një periudhë e gjatë që nga kryerja e krimeve, kujtesa e dëshmitarëve zbehet, dëshmitarët bëhen të paqasshëm ose nuk dëshirojnë ta konfirmojnë deklaratën e tyre në gjykim, ngaqë frikësohen për jetët dhe integritetin trupor të tyre apo të afërmeve të tyre, duhet të vendosen masa për t'i ruajtur provat si procedura të standardizuara.

b) Synimet

Të shtohet efikasiteti i punës së PSRK-së dhe NHKL të PK-së përkritazi me hetimin dhe ndjekjen penale të suksesshme (arrestimin e kryerësve, ngritjen e aktakuzave) të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare, duke siguruar se prokurorët dhe hetuesit i marrin të gjitha masat e domosdoshme në përputhje me KPP-në për t'i ruajtur provat dhe për t'i bërë të pranueshme në gjykatë.

c) Veprimet e nevojshme ²⁹

Kryeprokurori i PSRK-së të themelojë një ekip që ka për detyrë rishqyrtimin e lëndëve që janë hedhur poshtë dhe lëndëve nën hetim paraprak, me qëllim të grumbullimit të lëndëve që kanë veçori të ngjashme dhe me qëllim të zvogëlimit të rasteve, ku një dëshmitar thirret vazhdimisht për të dëshmuar për sfone identike të fakteve. ³⁰

²⁹ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i t'i ofrojë Kryeprokurorit të PSRK-së një analizë të hollësishme të shqyrtimit të tyre të lëndëve që janë hedhur poshtë dhe atyre nën ekzaminim paraprak, si dhe rezultatet e analizës së tyre për grumbullimin, në mënyrë që ekspertiza dhe praktika e tyre si sektor i drejtësisë në Kosovë të mund të shfrytëzohet si bazë, mbi të cilën mund të vazhdohet puna pas pranimit-dorëzimit. Nuk është ofruar një analizë e tillë.

³⁰ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i ta ofrojë analizën e vet dhe organizimin dhe grumbullimin të dhënës si një pikë referuese për të punuar dhe për të ecur përpara. Kjo nuk është ofruar.

Prokurorët e lëndëve, gjatë krijimit të strategjisë së tyre për ndjekje penale, do të sigurojnë përputhshmëri me dispozitat e KPP-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në konsideratat e mëposhtme:

- i) Të urdhërojnë përdorimin e audio dhe videoincizimit të marrjeve në pyetje dhe dëshmime në procedurën paraprake të zhvilluar nga prokurori i shtetit dhe policia;
- ii) Të kërkojnë nga gjyqtari i procedurës paraprake që ta marrë dëshminë nga një dëshmitar apo të kërkojnë një analizë të ekspertit, me qëllim të ruajtjes së provave në përputhje me nenin 149 të Kodit të Procedurës Penale;
- iii) Të zbatohet, kurdo që është e përshtatshme, instituti i marrëveshjes për pranimit të fajësisë, të referuar në nenin 233 të Kodit të Procedurës Penale dhe
- iv) Të shqyrtohet nëse i dyshuari apo i pandehuri mban asete të fituara përmes krimit dhe nëse po, t'i dorëzohet gjykatës kërkesa përkatëse procedurale për sekuestrim dhe konfiskim.

Prokurorët e lëndëve të përpilojnë me ndihmën e hetuesve, një protokoll të hetimit dhe strategjive të hetimit,³¹ duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- i) Identifikimin e synimeve dhe afateve të përkohshme të hetimit, roleve dhe përgjegjësisive të personelit të angazhuar, hulumtimin e mirëfilltë dhe analizën e sfondit të të gjitha materialeve në dispozicion me sfidat hetimore të identifikuar dhe zbrazëtirat në prova, llojin e provave që kërkohet;
- ii) Shabllonet për intervistimin e viktimave dhe dëshmitarëve, si dhe aktakuzat për krime të luftës;
- iii) Identifikimin e menjëhershëm, vlerësimin dhe analizën e çdo kërcënimi apo rreziku të mundshëm apo të raportuar ndaj dëshmitarëve potencialë që mund ta bëjë të nevojshme që Prokurori të parashtojë kërkesë për Mbrojtje të Dëshmitarit;
- iv) Marrjen dhe vlerësimin e informatave nga UNMIK-u, organizatat ndërkombëtare dhe rajonale si dhe organizatat joqeveritare, duke i përfshirë ato që janë aktive përkitazi me çështjet e dhunës seksuale gjatë kohës së luftës në Kosovë;

³¹ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuar që EULEX-i t'i dorëzojë protokollet relevante të hartuara për t'i përdorë si bazë, por asnjëra nuk është ofruar.

- v) Marrja e të dhënave relevante dhe të dokumentacionit përkitazi me personat e zhdukur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore;
- vi) Identifikimin e dëshmitarëve të mundshëm bashkëpunues;
- vii) Identifikimin e të dyshuarve që mbajnë përgjegjësi të niveleve më të larta (komandë dhe kontroll) në hierarkitë ushtarake dhe politike, me qëllim të tejkalimit të vështirësive në identifikimin e kryerësve kryesorë;
- viii) Vlerësimin e llojit të përgjegjësisë penale, duke përfshirë përgjegjësinë komanduese;
- ix) Vlerësimin e ligjit në fuqi dhe
- x) Analizën e praktikës relevante gjyqësore, duke iu referuar veçanërisht aktgjykimeve të formës së prerë të TNPJ-së (p.sh. aktgjykimet Milutinoviq dhe Gjorgjeviq), të cilat kanë dhënë vendime të rëndësishme përkitazi me rrethanat e rëndësishme faktike që janë tejet relevante për krimet e luftës, të kryera në Kosovë, të cilat gjykatat e Kosovës mund t'i "konsiderojnë të vërtetuara" (p.sh. ekzistimi i sulmit sistematik dhe të përhapur në një zonë të caktuar, në një kohë të caktuar, strukturat ushtarake të pranishme gjatë luftës, identifikimin e viktimave të një ngjarjeje të caktuar.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në bashkëpunim me PSRK-në dhe Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave, në konsultim me avokatët që i përfaqësojnë viktimat, të zhvillojnë politika dhe protokolle standarde për raportimin e rasteve të dhunës seksuale gjatë kohës së luftës në PSRK dhe NHKL e PK-së.

3.2. Krijimi i një bazë të dhënash për krime të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare në Kosovë; Përditësimi i regjistrit elektronik të PSRK-së

a) Pikat fillestare

PSRK-ja do të punojë drejt zhvillimit të një bazë të dhënash apo sistemi për

³²Për të siguruar që puna e kryer nga EULEX-i përdoritur vepronte si sistem i drejtësisë në Kosovë transferohet dhe përfshihet në sistemin e drejtësisë, tash e tutje, pas largimit të EULEX-it, PSRK-ja dhe NHKL-ja e PK-së kërkuar nga EULEX-i që të ofrojë: a) një analizë gjithëpërfshirëse të të gjithë praktikës juridike të UNMIK-ut dhe EULEX-it për të siguruar vazhdimësinë e jurisprudencës, b) shabllonet e intervistimit të dëshmitarëve, vlerësimet e rrezikut, aktakuzat, njoftimet dhe dokumentet e tjera ligjore të përgatitura dhe të parashtruara nga EULEX-i në kontekstin e punës së tyre; c) bazat e të dhënave të plota të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe përpjekjeve për ta siguruar vazhdimësinë e mekanizmave për mbrojtjen e dëshmitarëve, d) analizat ligjore të përdorura si bazë për praktikën e EULEX-it, e) materialet dhe arkivat e plota të organizuara në atë mënyrë që lehtësojnë kërkimet dhe analizat. Asnjëra nga këto materiale nuk u ofrua.

³³ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuar nga EULEX-i t'i ofrojë politikat dhe protokollet e tij për të shërbyer si bazë për zhvillimin e politikave dhe protokolleve shtesë nga ana e PSRK-së dhe NHKL e PK-së. Asnjëra nuk u ofrua.

Menaxhimin e lëndëve³⁴ lidhur me lëndët e mbetura dhe të përfunduara të krimeve të luftës dhe të shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare në Kosovë, që përditësohet rregullisht dhe është e qasshme për organet kompetente të hetimit dhe ndjekjes penale, me qëllim të përcjelljes së zhvillimit të lëndëve, të grumbullimit të lëndëve me tipare të ngjashme, të nxjerrjes së raporteve, të ofrimit të informatave të synuara për temën specifike dhe të caktimit të përparësisë së hetimeve.³⁵

PSRK-ja, gjithashtu, do të punojë drejt zhvillimit të një baze të dhënash të praktikës gjyqësore ndërkombëtare dhe rajonale për krimet e luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare për qëllime të hetimit dhe dokumentimit.

Në fund, një regjistër elektronik i PSRK-së u transferua nga EULEX-i më 14 dhjetor 2016.³⁶ PSRK-ja do ta vlerësojë relevancën dhe rëndësinë e këtij regjistri në punën e saj në vazhdim dhe duke bazuar në atë vlerësim, do t'i bëjë përditësimet dhe korrigjimet e nevojshme në regjistrin e dorëzuar nga EULEX-i. Nëse vendoset ashtu, një format tjetër mund të konsiderohet si vegël për këtë qëllim.

b) Synimet

Organet e Kosovës që janë kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të së drejtës penale të jenë në gjendje:

- i) Ta shqyrtojnë dhe përcjellin përparimin e të gjitha lëndëve të mbetura;
- ii) T'i sigurojnë, menaxhojnë, shqyrtojnë, kategorizojnë dhe zgjedhin të gjitha provat e mbledhura gjatë hetimit dhe t'i grumbullojnë lëndët që shfaqin tipare të ngjashme;
- iii) Ta shqyrtojnë dhe hulumtojnë praktikën juridike ndërkombëtare dhe rajonale.

Prokurorët e PSRK-së të jenë në gjendje të mbështeten në regjistrin e përditësuar elektronik.

³⁴ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i ta ofrojë sistemin e tij për menaxhimin e lëndëve për lëndët e mbetura dhe të përfunduara, por nuk është ofruar.

³⁵ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i t'i ofrojë informatat dhe shkathtësitë e nevojshme për ta marrë përsipër këtë sistem, por nuk janë ofruar.

³⁶ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i të ofrojë një version të përditësuar të regjistrin apo t'i bëjë korrigjimet e nevojshme në regjistër, por nuk është bërë asnjëra.

c) Veprimet e nevojshme

Si veprime të nevojshme kërkohet që:

- PSRK-ja ta furnizojë Njësinë për Hetimin e Krimeve të Luftës të Policisë së Kosovës me të dhëna të sakta të ngjarjeve që mund të cilësohen si krime lufte dhe shkelje të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare të kryera gjatë konflikteve të armatosura në territorin e Kosovës, si dhe të dhënat e lëndëve në pritje dhe të arkivuara, në mënyrë që të përdoren për grumbullimin e ngjarjeve dhe dhënien e përparësisë për lëndët që do të hetohen dhe ndiqen penalisht;
- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit me mbështetjen e KPK-së dhe NHKL të PK-së t'i krijojnë kushtet e domosdoshme për transferimin e Bazës së të dhënave "ZyLAB" të PSRK-ja dhe NHKL e PK-së dhe të ketë mbështetjen e institucioneve të Kosovës për financimin afatgjatë të Bazës së të dhënave "ZyLAB", ose për gjetjen e një mjeti alternativ për ruajtjen dhe analizimin e informatave;
- Personeli administrativ i PSRK-së ta përditësojë regjistrin elektronik të PSRK-së (ose ta mbajë të përditësuar çdo mjet tjetër që përdoret për organizimin elektronik të lëndëve), duke siguruar që çdo lëndë është e regjistruar me një numër përkatës regjistrimi, që të hiqen regjistrimet e shumta për të njëjtën lëndë, që emrat e të gjithë të dyshuarve dhe të akuzuarve të radhiten në regjistër, përveçse në rastet kur informatat duhet të mbahen konfidenciale, etj;
- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, PSRK-ja dhe NHKL e PK-së të caktojnë dhe trajnojnë personelin administrativ se si t'i fusin të dhënat fillestare dhe si t'i mirëmbajnë sistemet të përditësuara vazhdimisht dhe
- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, PSRK-ja dhe NHKL e PK-së ta trajnojnë personelin e autorizuar, duke përfshirë prokurorët, zyrtarët ligjorë dhe zyrtarët policorë, për t'i përdorur sistemet e menaxhimit të lëndëve dhe bazave të të dhënave.

³⁷ PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan që EULEX-i të ofrojë mbështetje në transferimin e Bazës së të Dhënave "ZyLAB" për të siguruar transferimin e shkathtësive të nevojshme për përdorimin e saj. Që nga tetori 2018 nuk është ofruar asnjë transferim, mbështetje apo trajnim i tillë.

3.3. Bashkëpunimi rajonal

a) Pikat fillestare

Hetimet dhe ndjekjet penale efektive të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë fatin e personave të zhdukur, kërkojnë bashkëpunim rajonal me organet hetimore dhe të ndjekjes të themeluara në territorin e ish-Jugosllavisë.

Deri më tani, mungesa apo zbatimi i pamjaftueshëm i protokolleve të bashkëpunimit ndërmjet prokurorive në krye të hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë fatin e personave të zhdukur, ka rezultuar në një shkallë të pakënaqshme të bashkëpunimit shkëmbimit të informatave në nivel rajonal.

Mungesa e një plani strategjik apo marrëveshjeje ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë përkitazi me krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë fatin e personave të zhdukur, ka rezultuar në një bashkëpunim apo shkëmbim informatash që, pothuajse, nuk ekziston ndërmjet organeve të ndjekjes penale të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorëve për Krime të Luftës të Serbisë. I vetmi protokoll ekzistues i bashkëpunimit është ai ndërmjet Policisë së EULEX-it dhe MUP-it serb.

b) Synimet

Si synime shihen që:

- Të vendoset një bashkëpunim më efikas me shtetet në rajon lidhur me krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe
- Të hapet një kanal formal i komunikimit, shkëmbimit të informatave dhe bashkëpunimit ndërmjet organet e prokurorisë dhe Policisë së Kosovës në njërën anë dhe Zyrës së Prokurorëve për Krime të Luftës dhe Policisë së Serbisë, në anë tjetër, për krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë fatin e personave të zhdukur.³⁸

³⁸EULEX-i është dashur të luante një rol kyç në mbështetjen e krijimit të kësaj marrëdhënieje të bashkëpunimit. Për fat të keq, nuk është ofruar një mbështetje e tillë.

c) Veprimet e nevojshme

Në fushën e kompetencave të tyre përkatëse, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe NHKL të PK-së në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të zhvillojnë dhe miratojnë protokolle të bashkëpunimit ndërmjet prokurorive në krye të hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke përfshirë edhe fatin e personave të zhdukur me secilin nga vendet e rajonit dhe duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a) Caktimin e takimeve ndërmjet prokurorëve dhe hetuesve rajonalë për të diskutuar lëndët specifike të dorëzuara dhe çështjet që dalin në bashkëpunimin rajonal përkitazi me ato lëndë;
- b) Themelimin e ekipeve të përbashkëta ndërkufitare të hetimit dhe ndjekjes penale;
- c) Vendosijen e një procedurë të njëtrajtshme për bashkëpunim, i cili ka për qëllim ndriçimin e fatit të personave të zhdukur;
- d) Krijimin e procedurave të koordinuara dhe në pajtim bilateral sa i përket transferimit të mundshëm të procedurave penale;
- e) Rritjes së bashkëpunimi përkitazi me kërkesat për ndihmë juridike reciproke apo ndërkombëtare;
- f) Vendosijen e obligimit për ta informuar palën tjetër rreth proceduarve penale të filluara kundër shtetasve të tyre dhe
- g) Krijimi i një liste të rasteve me përparësi për bashkëpunim.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të zhvillojnë dhe miratojnë një protokoll të bashkëpunimit ndërmjet PSRK-së dhe Zyrës së Prokurorëve të Krimeve të Luftës të Serbisë, në bazë të draftit ekzistues me qëllim që:

- (a) Ta ndihmojnë njëra tjetrën në identifikimin, shkëmbimin dhe komunikimin e informatave për krimet e luftës apo aktivitetet e ndërlidhura kriminale;

- (b) Ta këshillojnë njëra tjetrën për hapat hetimorë dhe proceduralë dhe për shkëmbim informatash pas kërkesës së bërë nga palët rreth ndonjë zhvillimi, veprimi apo hapave të tjerë hetimorë dhe proceduralë, përkitazi me krimet e luftës dhe aktivitetet e ndërlidhura kriminale;
- (c) Ta informojnë njëra tjetrën rreth statusit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike të dorëzuara në përputhje me procedurat për ndihmën e ndërsjellë juridike dhe ta ndihmojnë njëra tjetrën me çështjet praktike që do të mundësonin qartësimin e çështjeve që shfaqen dhe mundësojnë ekzekutimin e shpejtë të kërkesave;
- (d) Ta këshillojnë njëra tjetrën rreth kornizës ligjore relevante, duke përfshirë përditësimet lidhur me hyrjen në fuqi të legjislacionit, rregullave dhe rregulloreve dhe informatave të tjera ligjore lidhur me krimet e luftës apo aktivitetet e ndërlidhura kriminale;
- (e) Ta informojnë njëra tjetrën për procedurat penale të filluara kundër shtetasve të palës tjetër dhe
- (f) Ta përpilojnë një listë të lëndëve me përparësi për bashkëpunim.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të angazhohen me Ministrinë e Punëve të Brendshme për të verifikuar vullnetin e Kosovës dhe Serbisë për të zgjeruar protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe MPB të Serbisë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të përcaktojë dhe zhvillojë modele të raportimit për rastet e dështimit të homologëve rajonale për t'i ekzekutuar kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare ose të ndërsjellë.

3.4. Bashkëpunimi me MTPN-në

a) Pikat fillestare

Një zbatim i suksesshëm i kësaj strategjie, me qëllim të caktimit të përparësisë së lëndëve, kërkon aktivizimin e bashkëpunimit formal me mekanizmin e mbetur për tribunalet penale ndërkombëtare (MTPN), me qëllim për të pasur qasje në dokumentet, informatat dhe provat e përdorura në procedurat para Tribunalit Ndërkombëtar Penal për ish-Jugosllavinë (TNPJ).

Prokuroria e MTPN-së, aktualisht, bashkëpunon me shtetet e tjera në rajonin e Ballkanit për transferimin e provave.

Prokurorët e EULEX-it kanë bashkëpunuar me sukses me TNPJ-në dhe MTPN-në për lëndët e krimeve të luftës. Megjithatë, organet e Kosovës që janë kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare ende nuk kanë arritur të kenë bashkëpunim të plotë me MTPN-në. Më konkretisht, nuk ka marrëveshje formale me MTPN-në lidhur me transferimin dhe përdorimin e provave dhe materialeve të mbledhura nga këto institucione.³⁹

b) Synimet

Organet e ndjekjes penale të Kosovës që janë kompetente për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare të njihen si organe që kanë të drejtë të bëjnë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare në Regjistrin e MTPN-së, me qëllim të marrjes së dokumenteve, informatave dhe provave të përdorura në procedurat para TNPJ-së dhe, në veçanti, kopjet e vërtetuara të provave dhe deklaratat e redaktuara të dëshmitarëve.

Kosova të përfshihet në programin e Zyrës së Prokurorit të MTPN-së për dorëzimin e provave dhe materialeve tjera.

c) Veprimet e nevojshme

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja të ndërlidhen me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ta hapur një kanal formal të komunikimit me MTPN-në, me qëllim të:

- a) Verifikimit të vullnetit të MTPN-së për ta përfshirë Kosovën në programin e Zyrës së Prokurorit të MTPN-së për dorëzimin e provave;
- b) Hartimit të një memorandumi të mirëkuptimit apo marrëveshjes me MTPN-në për parashtrimin (nga një organ i Kosovës apo ndonjë ndërmjetës tjetër i pranuar) dhe ekzekutimin e kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare te Zyra e Prokurorisë dhe e Shkrimores së MTPN-së, me qëllim të marrjes së dokumenteve, informatave dhe provave;

³⁹EULEX-i është dashur të luante një rol kyç në mbështetjen e krijimit të kësaj marrëdhënieje të bashkëpunimit. Për fat të keq, nuk është ofruar një mbështetje e tillë.

- c) Krijimit të një mekanizmi për marrjen nga MTPN-ja të dokumentacionit të arkivuar të TNPJ-së lidhur me krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të së drejtës humanitare, të kryera në Kosovë dhe
- d) Futjes së legjislacionit të domosdoshëm për mundësimin e transferimit dhe përdorimit të provave dhe materialeve të tjera nga TNPJ-ja dhe MTPN-ja në Kosovë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të përcaktojë dhe zhvillojë modele të raportimit për rastet e dështimit të homologëve ndërkombëtarë për t'i ekzekutuar kërkesat për ndihmë juridike ndërkombëtare ose të ndërsjellë.

Kronologjia

3.5. Bashkëpunimi me Interpolin dhe Europolin

a) Pikat fillestare

Bashkëpunimi me Interpolin dhe Europolin është i rëndësisë thelbësore në kontekstin e aktivitetit modern kriminal dhe kundërveprimit nga organet për zbatim të ligjit.

Kosova nuk është anëtare e Interpol-it dhe Europol-it.

Aktualisht, Njësia për Bashkëpunim e Policisë Ndërkombëtare të EULEX-it (NBPN) është duke lehtësuar shkëmbimin e informatave për Njësinë e Bashkërendimit me Organet Ndërkombëtare për Zbatim të Ligjit (në vijim: NBONZL) të Policisë së Kosovës, drejtpërdrejt dhe përmes Zyrës së UNMIK-ut për Ndërlidhje me Interpol-in, përmes një protokollit për bashkëpunim policor me: Interpol-in, Europolin dhe MPB-në serbe.

Aktualisht nuk ka indikacione të qarta nëse dhe kur do të ndodhë anëtarësimi i Kosovës në Interpol dhe Europol.

b) Synimet

Të përmirësohen mënyrat e bashkëpunimit ndërmjet organeve hetimore me Interpol-in dhe Europol-in deri në kohën kur Kosova të bëhet anëtare e organizatave të lartcekura, duke iu referuar veçanërisht shkëmbimit të përshpejtuar dhe efikas të informatave në raste urgjente dhe të ndërlikuara, që kërkojnë ekspertizë vendore dhe ndërkombëtare.

c) Veprimet e nevojshme

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë të angazhohen me Ministrinë e Punëve të Brendshme për ta verifikuar vullnetin e Prishtinës dhe Beogradit për ta zgjeruar protokollin e bashkëpunimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe MPB-së së Serbisë.

3.6. Bashkëpunimi me Organizatat e Shoqërisë Civile (“OSHC”) dhe Organizatat Joqeveritare (“OJQ”)

a) Pikat fillestare

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) dhe Organizatat Joqeveritare (“OJQ”) mund të japin kontribut të çmuar në hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë zhvillimin e politikave dhe praktikave më të mira.

Më konkretisht, OJQ-të për të drejtat e njeriut i dokumentojnë shkeljet, mund të kenë njohuri të drejtpërdrejtë për shkeljet, mund të ofrojnë informata për kontekstin, në të cilin kanë ndodhur shkeljet dhe në shabllonet e ngjarjeve, mund të kenë kontakte me viktimat dhe dëshmitarët, si dhe mund të ndihmojnë për t’ua komunikuar punën e organeve hetimore dhe të ndjekjes penale viktimave dhe komuniteteve të prekura nga krimet.

b) Synimet

Të themelohen mënyra të bashkëpunimit ndërmjet organeve hetimore dhe OSHC-ve dhe OJQ-ve në përputhje me ligjin në fuqi.

c) Veprimet e nevojshme

Prokurorët e lëndëve dhe hetuesit të:

- a) Monitorojnë dhe shqyrtojnë informatat e burimeve të hapura nga OSHC-të dhe OJQ-të relevante, duke i përfshirë raportet publike për krimet e pretenduara dhe personat e përfshirë, memorandumet ligjore dhe artikujt hulumtues;
- b) Ndërveprojnë me OSHC-të dhe OJQ-të për shkëmbim të informatave me qëllim të identifikimit të viktimave të mundshme, dëshmitarëve dhe kryerësve, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të pjesëmarrjes dhe mbrojtjes së viktimave në procedurat penale dhe
- c) Marrin këshilla nga OSHC-të dhe OJQ-të se si të komunikojnë me viktimat dhe dëshmitarët në komunitetet e prekura.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja të marrin parasysh zhvillimin dhe nënshkrimin e memorandumëve të bashkëpunimit me OSHC-të dhe OJQ-të relevante, me synim të nxitjes së bashkëpunimit në fushën e shkëmbimit të informatave, zbulimit të veprave penale me qëllim të identifikimit dhe ngritjes së akuzave kundër kryerësve, si dhe në aspektin e organizimit të takimeve, seminareve dhe trajnimeve sipas nevojës.

3.7. Dosjet e personave të zhdukur

a) Pikat fillestare

Afro dymijë (2000) dosje të personave të zhdukur lidhur me rrëmbimin ose zhdukjen e njerëzve gjatë dhe pas luftës janë duke u transferuar nga NJHKL-ja e EULEX-it te NjHKL-ja e Policisë së Kosovës.⁴⁰

Rastet e zhdukjeve të detyruara dhe rrëmbimet e kryera në kontekstin e konfliktit duhet të hetohen në mënyrë të plotë për të siguruar që ata që janë përgjegjës, duke i përfshirë komandantët dhe eprorët civilë, të cilët do të dënohen në përputhje me peshën e veprimeve të tyre.

⁴⁰EULEX-i nuk i ka zhvilluar hetimet për këto dosje dhe është duke ia dorëzuar NHKL të PK-së për veprim të mëtejshëm.

PSRK-ja dhe NHKL-ja e PK-së të përcaktojnë se deri në ç'masë informatat që ndodhen në dosjet e personave të zhdukur janë të përfshira në dosjet përkatëse të procedurave penale. Fakti se për këto dosje EULEX-i nuk ka ndër marrë veprime e bën këtë detyrë akoma më urgjente.

Bashkëpunimi ndërmjet Prokurorit të Shtetit dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe bashkëpunimi rajonal në këtë fushë dhe me institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare është thelbësor për hetimin e suksesshëm të rrëmbimit dhe zhdukjes së njerëzve, që kanë ndodhur gjatë dhe pas luftës.

b) Synimet

Prokurori i Shtetit të sigurojë që të gjitha informatat e përfshira në dosjet e personave të zhdukur do të shqyrtohen hollësisht me qëllim të hetimit të mundshëm dhe ndjekjes penale.

c) Veprimet e nevojshme

Prokurori i Shtetit ta themelojë një ekip, i cili përfshin përfaqësuesit e PSRK-së, NHKL-së së PK-së dhe IML-së, të cilët ngarkohen për shqyrtimin e dosjeve të personave të zhdukur, më qëllim të:

- A) Zhvillimit të një liste gjithëpërfshirëse të lëndëve të personave të zhdukur;
- B) Grumbullimit të dosjeve që shfaqin tipare të njëjta;
- C) Marrjes nga IML-ja e të dhënave dhe dokumentacionit relevant përkitazi me personat e zhdukur dhe krahasimit të tyre me lëndët e regjistruara;
- D) Sigurimit që lëndët reflektohen në procedura penale çdo herë kur ka indikacione për kryerjen e një vepre penale;
- E) Përditësimin të bazës relevante të të dhënave duke u bazuar në të dhënat e përfshira në dosjet e personave të zhdukur.

3.8. Mbrojtja e dëshmitarëve

a) Pikat fillestare

Sipas Ligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, i ndryshuar:

- 1) Kërkesat me shkrim për përfshirje në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve do t'i dorëzohen Kryeprokurorit të Shtetit. Kërkesa mund të dorëzohet, ndër të tjera, nga prokurori kompetent i shtetit dhe

2) Komisioni për Mbrojtjen e Dëshmitarëve përbëhet prej tre (3) anëtarëve, gjegjësisht, Kryeprokurori i Shtetit të Republikës së Kosovës, Shefi i Njësisë së Hetimeve të Policisë së Kosovës dhe Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve. Kryesues i Komisionit është Kryeprokurori i Shtetit.

b) Synimet

Sistemi i mbrojtjes së dëshmitarëve në lëndët e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare për të siguruar që dëshmitarët që përballen me frikë të justifikueshme për rrezik ndaj jetës, shëndetit fizik apo mendor, për veten e tyre apo të afërmit e tyre dhe që pranojnë të bashkëpunojnë për së afërmi me gjykatat apo organet hetuese të Kosovës mund të përfitojnë në mënyrë efektive nga masat e jashtëzakonshme të mbrojtjes, të parapara me ligj.

Të rritet besimi në sistemin mbrojtës të Kosovës.

c) Veprimet e nevojshme

Prokurori i lëndës duhet:

- a) Ta vlerësojë me kujdes nevojën për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dorëzojë te Kryeprokurori i Shtetit kërkesa për përfshirjen e dëshmitarëve në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve;
- b) Të vëzhgojë për ndonjë zbulim të sekretit zyrtar përkitazi me dokumentet dhe të dhënat lidhur me zbatimin e një programi të caktuar për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe t'i zbatojë dispozitat e Kodit Penal në mënyrë të vazhdueshme dhe
- c) Të shqyrtojë nëse duhet të mbahet i fshehtë identiteti i dëshmitarit, duke përfshirë në kërkesën e tij, përbrenda procesit ku kërkohet mbrojtja.

Kryeprokurori i Shtetit, KPK-ja dhe Drejtorja për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të zhvillojnë:

- a) Udhëzime dhe urdhëresa për veprim në çështje të interesit të përbashkët;⁴¹

⁴¹PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan nga EULEX-i që t'i dorëzojnë udhëzimet dhe urdhëresat e tyre për këto çështje si bazament për zhvillimin e udhëzimeve të përforcuara. Asgjë nuk është ofruar.

- b) Trajnime të përbashkëta për personelin e prokurorisë, personelin relevant të NHKL-së të PK-së, Zyrën e Mbrojtjes së Viktimave apo përfaqësuesit e tjerë të viktimave dhe personelin e caktuar në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve, aty ku është e mundur⁴² dhe
- c) Tryeza pune me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe përmirësimit të operacioneve të përbashkëta.

Kryeprokurori i Shtetit, KPK-ja dhe Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të angazhohen me organet kompetente të Qeverisë së Kosovës që:

- a) Të sigurojnë se ka fonde të mjaftueshme për zbatimin e dispozitës së Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve;
- b) Të kërkojnë dhe të sigurojnë marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe për zhvendosje me shtetet jashtë Kosovës dhe të mundësojnë zbatimin e marrëveshjeve të tilla dhe
- c) Të sigurojnë që kapaciteti institucional në kuptim të burimeve njerëzore dhe aftësive teknike për mbrojtje të dëshmitarëve është i mjaftueshëm.

A) Pikat fillestare

Viktimat, palët e dëmtuara dhe dëshmitarët e krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare duhet t'i japin dëshmitë e tyre të lirë nga çfarëdo kërcënimi, frikësimi apo ndonjë forme tjetër të trysnisë psikologjike dhe rrezikut të riviktimizimit, duke përfshirë ekspozimin e tepërt në media.

Gjatë procedurave penale, viktimat e dhunës seksuale nuk duhet të vuajnë nga stigmatizimi dhe riviktimizimi, duke u përqendruar vetëm në përvojën e tyre, po ashtu, duke mos e marrë parasysh në mënyrë të arsyeshme respektin për privatësinë e tyre apo për nevojën e tyre për mbështetje psikologjike, emocionale dhe administrative.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave është themeluar përbrenda Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe ka për detyrë parësore sigurimin e mbrojtjes së të drejtave të viktimave, duke iu ofruar udhëzime, këshilla dhe mbështetje në sistemin e drejtësisë dhe në strehimore, qendra shëndeti dhe shërbime të tjera shoqërore.

⁴²PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuan nga EULEX-i që t'i ofrojnë modulet e trajnimit dhe materialet burimore që janë përdorur për t'i zhvilluar trajnimet e tyre si bazë për trajnime në të ardhmen. Asgjë nuk është ofruar.

Regjistri i praktikës juridike të UNMIK-ut dhe EULEX-it tregon se palët e dëmtuara shumë rrallë kanë sukses në marrjen e kërkesave pronësore që rrjedhin nga kryerja e një vepre penale, në formë të kompensimit për dëmet gjatë procedurës penale. Një sukses i ulët i tillë është demotivues për viktimat që të marrin pjesë në procedurat penale. PSRK-ja merr përsipër të forcojë përpjekjet në këtë drejtim.⁴³

Zyra për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave rrallëherë i përdor instrumentet ligjore të përcaktuara në nenin 467 të KPP-së, që japin mundësinë e sigurimit të masave të përkohshme për t'i siguruar kërkesat pronësore, duke i konfiskuar pronat e të pandehurve. Si rrjedhojë, madje-madje, edhe në rastet kur përgjegjësia penale konstatohet me aktgjykim të formës së prerë, mundësia e kompensimit monetar të viktimave dhe palëve të tjera të dëmtuara, duke i konfiskuar pronat e personave të dënuar është shumë e kufizuar. PSRK-ja merr përsipër që t'i forcojë përpjekjet drejt këtij qëllimi.

A) Synimet

Prokurori i lëndës dhe NHKL e PK-së ta shtojnë bashkëpunimin me Zyrën për Mbrojtje dhe Ndhimë Viktimave, si dhe me përfaqësuesit e tjerë ligjorë të viktimave kur është e mundur dhe të vendosen dhe zbatohen masa për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, palëve të dëmtuara në një fazë të mëhershme (që në fazën parahetimore), me qëllim të përmirësimit të situatës së tyre dhe për të mundësuar një bashkëpunim më efektiv në raportimin dhe hetimin e ndjekjen penale të krimeve të luftës.⁴⁴

B) Veprimet e nevojshme

Prokurorët e lëndës dhe hetuesit me Zyrën për Mbrojtjen dhe Ndhimën e Viktimave nevojityet që:

- a) T'i marrin të gjitha masat e arsyeshme për ta mbrojtur privatësinë dhe për të garantuar sigurinë e viktimave dhe palëve të dëmtuara, si dhe dëshmitarëve, duke përfshirë edhe zbatimin e masave të mbrojtjes, të cilat janë paraparë me KPP-në kurdo që është e mundur;

⁴³ Praktika e tillë mund t'i zhgënjë viktimat dhe mund t'i dekurajojë nga pjesëmarrja në procedurat penale.

⁴⁴ PSRK-ja kërkoi që EULEX-i t'i ofrojë modelet për këtë bashkëpunim, që i kanë zhvilluar dhe përdorur në praktikë, në mënyrë që të mund t'i përdorë ato modele. Asgjë nuk është ofruar.

- b) Të mos zbulojnë në mënyrë të papërshtatshme informata që mund ta rrezikojnë sigurinë e palëve të dëmtuara, dëshmitarëve dhe viktimave;
- c) Ta bëjnë një vlerësim të kërcënimeve, ndaj të cilave mund të ekspozohet një dëshmitar apo i afërm i ngushtë si rezultat i ndihmës së dëshmitarit në një hetim apo i vendimit të tij/saj për të dëshmuar në procedurë gjyqësore dhe të zbatojnë çdo masë të nevojshme për ta zvogëluar çdo rrezik të identifikuar;
- d) Ta vlerësojnë nevojën dhe t'i zbatojnë masat që nevojiten për ta mundësuar dëshminë e dëshmitarëve të cenushtëm (për shembull, të miturit, viktimat e dhunës seksuale dhe gjinore), duke përfshirë përkrahjen psikosociale, persona përkrahës, teknika të veçantë të intervistimit;
- e) Të sigurojnë që palët e dëmtuara, viktimat dhe dëshmitarët çdoherë janë të informuar për të drejtat dhe detyrimet e tyre sa i përket pjesëmarrjes në procedura kriminale (informata të plota se ç'pritet nga ta, rreziqet që mund t'i hasin, masat mbrojtëse që i kanë në dispozicion dhe kufizimet e atyre masave, detyrimet lidhur me dhënien e informatave gjykatës dhe mbrojtjes), si dhe përkitazi me zhvillimin e lëndës, duke u bazuar në dispozitat e KPP-së dhe në Rregulloren e KPK-së për mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për Ndihmë dhe Mbrojtje të Viktimave dhe në Urdhëresën e Kryeprokurorit të Shtetit për Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave;
- f) T'i marrin pikëpamjet e palëve të dëmtuara dhe të viktimave në një fazë të hershme, para fillimit të hetimeve dhe të vazhdojnë t'i vlerësojnë interesat e tyre në bazë të vazhdueshme;
- g) T'i marrin të gjitha masat e arsyeshme për shmangien e riviktimizimit të palëve të dëmtuara dhe viktimave, duke i përfshirë masat për t'i shmangur situatat ku dëshmia në procedurë penale do të shkaktonte vuajtje dhe traumatizim shtesë, duke iu dhënë vëmendje të veçantë viktimave të dhunës seksuale dhe
- h) Të inkurajojnë që kompensimi i dëmeve që burojnë nga krimet e luftës do të kërkohet përbrenda procedurës penale dhe që masat e përkohshme për sigurimin e kërkesave pronësore të parashtrohen me kohë në përputhje me nenin 467 të KPP-së, kur është mundshme dhe e nevojshme.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në bashkëpunim me Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave dhe përfaqësuesit e tjerë të viktimave, aty ku është e mundur, të formulojnë një protokoll për informimin e viktimave dhe palëve të dëmtuara në lidhje me të gjitha aspektet e lëndëve të tyre, për të cilat kanë të drejtë të informohen ose kanë interes legjitim për të ditur (siç është parashtrimi i ankesave që ndikojnë në pozitën procedurale të palëve të dëmtuara, nxjerrjen e aktgjyqimeve, pushimin e masave kufizuese të caktuara ndaj të pandehurit etj).

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, KPK-ja dhe NHKL e PK-së të zhvillojnë dhe të instalojnë trajnime të specializuara për prokurorët dhe hetuesit për të siguruar rritjen e vazhdueshme të aftësive të tyre profesionale në fushën e shkathtësive të intervistimit, ndjeshmërisë ndaj traumës psikologjike që viktimat kanë përjetuar, të drejtat e dëshmitarëve dhe viktimave, duke përfshirë të drejtën e tyre për pjesëmarrje në hetimin dhe ndjekjen penale, mbrojtjen e tyre dhe parandalimin e riviktimizimit.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të zhvillojë dhe organizojë trajnime dhe pjesëmarrje në konferenca rajonale dhe ndërkombëtare dhe seminare teknike për personelin e Zyrës për Mbrojtjen dhe Ndihmën e Viktimave, me qëllim të ruajtjes dhe përmirësimit të cilësisë së punës së tyre.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, KPK-ja dhe NHKL e PK-së të angazhohen me organet kompetente të Qeverisë së Kosovës për rekrutimin, trajnimin dhe punësimin e zyrtarëve të specializuar (psikologë dhe punonjës socialë) për të ofruar mbështetje psikologjike, emocionale dhe administrative për viktimat, palët e dëmtuara dhe dëshmitarët.

3.10. Strategjia mediale

A) Pikat fillestare

Duke respektuar plotësisht konfidencialitetin e hetimeve dhe mbrojtjen e viktimave, palët e dëmtuara dhe dëshmitarët, organet e ndjekjes penale kanë për detyrë t'u japin qytetarëve informata të sakta dhe të plota rreth procedurave penale në bazë të parimeve të transparencës dhe llogaridhënies.

b) Synimet

Në këtë kontekst nevojitet që:

- Të ngrihet shkalla e vetëdijes publike për ngjarjet në ish-Jugosllavi dhe për nevojën e zbulimit, hetimit dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare, duke u bazuar në parimet e përgjegjësive penale individuale pavarësisht gradës apo përkatësisë kombëtare, etnike dhe fetare të kryerësit dhe
- Të zhvillohet dhe zbatohet një model efikas dhe i qëndrueshëm për informimin e publikut.

c) Veprimet e nevojshme

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit në bashkëpunim me KPK-në në përputhje me Strategjinë për Komunikim Publik të Sistemit Prokurorial 2018-2020 të zhvillojë dhe të instalojë trajnime të specializuara për zëdhënësit e PSRK-së dhe prokurorët e lëndëve për komunikim publik.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe PSRK-ja të publikojnë raporte të rregullta rreth punës së institucioneve përgjegjëse për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe shkeljeve të tjera të së drejtës ndërkombëtare humanitare.

4. Menaxhimi i rrezikut

Janë identifikuar këto rreziqe strategjike dhe veprime përkatëse lehtësuese:

- a) Rreziku që shtimi i paraparë i vëllimit të punës së PSRK-së dhe NHKL-të PK-së mund të ndikojë negativisht në koherencën apo afatshmërinë, efektivitetin dhe efikasitetin e hetimeve dhe ndjekjes penale të lëndëve.

Veprimet lehtësuese, të cilat duhet të shtjellohen dhe të zbatohen protokolle të hollësishme të hetimeve/strategjive hetimore për përdorimin e resurseve në dispozicion dhe caktimin e përparësisë së lëndëve;⁴⁵

- b) Rreziku që PSRK-ja dhe NHKL e PK-së mund të kenë numër të pamjaf-tueshëm të njerëzve me shkathtësitë dhe njohuritë e domosdoshme.

⁴⁵PSRK-ja dhe NHKL e PK-së kërkuar që EULEX-i t'i ofrojë protokollet e veta të hollësishme për t'i mundësuar PSRK-së që ta vazhdojë punën që është bërë deri më tani, por asgjë nuk është ofruar.

Veprimet lehtësuese: të përgatiten raporte të vazhdueshme rreth zbatimit të Strategjisë dhe të angazhohen me Ministrinë e Drejtësisë, përkatësisht, Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe KPK-në, në mënyrë që të rritet numri i prokurorëve, hetuesve dhe personelit mbështetës të kualifikuar që është caktuar në Sektorin për Krime të Luftës të PSRK-së dhe në NHKL të PK-së, duke përfshirë promovimin për ndryshimin e legjislacionit të tashëm për resurset që u ndahen zyryave përkatëse.

- c) Rreziku që bashkëpunimi i kufizuar me partnerët e jashtëm (për shembull, organet e ndjekjes dhe hetimeve në rajonin e Ballkanit, organet ndërkombëtare) mund të ketë ndikim negativ në përparimin e hetimeve.

Veprimet lehtësuese: të vazhdohet me zhvillimin dhe mbajtjen e kontakteve të rregullta me palët kyçe të interesit përmes takimeve dhe iniciativave të përbashkëta, si dhe të angazhohen me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme respektivisht për nxitjen e hartimit dhe zbatimit të memorandumeve të bashkëpunimit.

- d) Rreziku që PSRK-ja dhe NHKL e PK-së nuk do t'i kenë në dispozicion dhe në afatet e parapara bazat e nevojshme të të dhënave, infrastrukturën e teknologjisë informative dhe personelin për t'i përcjellë zhvillimet e lëndëve, për t'i grumbulluar rastet që shfaqin tipare të ngjashme, për të përpiluar raporte dhe për t'i priorizuar hetimet.

Veprimet lehtësuese: të caktohet përparësia e lëndëve në bazë të kriterëve të paraqitura në Strategji, duke u angazhuar njëkohësisht me organet kompetente të Kosovës, me qëllim të vendosjes së sistemeve të domosdoshme të databazave dhe menaxhimit të lëndëve, por edhe të jepen fondet e domosdoshme për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e tyre, me përkrahjen e partnerëve ndërkombëtarë nëse është e domosdoshme.

- e) Rreziku që viktimat, dëshmitarët dhe palët e dëmtuara nuk do të mbështeten në mënyrë efektive për shkak të pamjaftueshmërisë së resurseve dhe personelit të kualifikuar.

Veprimet lehtësuese: të vazhdohet me zhvillimin e protokolleve për përkrahjen dhe mbrojtjen e viktimave, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, duke përfshirë bashkëpunimin me mbrojtësit e viktimave apo përfaqësuesit e tjerë ligjorë dhe të angazhohen me Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Organizatat Joqeveritare në këtë fushë.

5. Monitorimi i strategjisë

Strategjia e tashme kërkon një mekanizëm për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të zbatimit të veprimeve të nevojshme kundrejt rezultateve të pritshme.

Për këtë qëllim, një trup monitorues, i përbërë nga Kryesuesi i KPK-së, Kryeprokurori i Shtetit, Kryeprokurori i PSRK-së, Shefi i NJHKL-së të PK-së dhe një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, do të themelohet për të kontrolluar në mënyrë të rregullt dhe të planifikuar përparimin e zbatimit të Strategjisë për ta përmirësuar punën, për të siguruar llogaridhënie dhe për të bërë modifikime të zbatimit nëse është e domosdoshme.

Trupi monitorues do t'i përcaktojë dhe zhvillojë modelet e raportimit së paku çdo tre muaj për progresin e zbatimit të veprimeve të nevojshme, duke u bazuar në indikatorët, por që nuk kufizohen në:

- a) Rezultatet objektive të aktivitetit të planifikuar (numër i shtuar i aktakuzave përkitazi me numrin e hetimeve në lëndët me përparësi, numër i shtuar i procedurave të përfunduara përkitazi me numrin e aktakuzave, kohëzgjatja mesatare e hetimeve të krimeve të luftës dhe krimeve të tjera të rënda sipas të drejtës ndërkombëtare, numër i shtuar i lëndëve të filluara dhe të përfunduara për shkak të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, numër i shtuar i hetimeve penale të lëndëve për personat e zhdukur dhe numri i lëndëve të grumbulluara të zgjedhura përmes kriterëve të caktimit të përparësisë);
- b) Devijimin nga afati kohor;
- c) Resurset e mjaftueshme në dispozicion;

- d) Përkrahjen e palëve të tjera institucionale të interesit;
- e) Ndryshimet e politikave dhe
- f) Ndikimin që zbatimi ka në hetimin dhe ndjekjen penale të suksesshme të lëndëve me përparësi

Trupi monitorues do të takohet së paku dy herë në vit.

Trupi monitorues do t'i dorëzojë raporte vjetore Këshillit Prokurorial të Kosovës për zbatimin e përgjithshëm të Strategjisë.

Trupi monitorues do të vendosë rreth mënyrës së pjesëmarrjes së përfaqësuesve të shoqërisë civile, organizatave mediatike dhe ndërkombëtare në procesin e monitorimit në përputhje rigoroze me ligjin në fuqi dhe konfidencialitetin e hetimeve të veprave penale.

